

KOLEGJI BIZNESI
ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

RAPORTI PËRMBLEDHËS
I REZULTATEVE TË VLERËSIMIT NGA VLERËSIMI
NDËRKOLEGIAL PËR 2024/25

Prishtinë, 2025

Hyrje

Kolegji Biznesi, si Institucion i Arsimit të Lartë i themeluar në vitin 2004, në mënyrë të vazhdueshme ndërmerr veprime konkrete për sigurimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor, performancës akademike dhe zhvillimit institucional. Në kuadër të mekanizmave të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, institucioni realizon në mënyrë periodike procese të vlerësimit të performancës së stafit akademik, përfshirë edhe vlerësimin ndërkolegial, me qëllim forcimin e bashkëpunimit profesional, avancimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve akademike dhe institucionale.

Raporti përmbledhës i vlerësimit ndërkolegial për vitin 2024/2025 paraqet rezultatet e procesit të vlerësimit të stafit akademik nga kolegët e tyre, duke përfshirë aspektet e bashkëpunimit profesional, komunikimit ndërkolegial, respektimit të etikës profesionale dhe kontributit në aktivitetet institucionale. Ky proces vlerësimi synon të sigurojë monitorimin sistematik të marrëdhënieve profesionale dhe performancës ndërkolegiale, si dhe të identifikojë fushat që kërkojnë përmirësim në funksion të rritjes së cilësisë së përgjithshme institucionale.

Kolegji Biznesi disponon mekanizma të qartë dhe funksionale për matjen dhe monitorimin e cilësisë, ku procesi i vlerësimit mbikëqyret dhe analizohet në mënyrë të vazhdueshme nga menaxhmenti i institucionit, përfshirë Dekanin, Prodekanët, Përgjegjësit e Programeve Studimore dhe Koordinatorët për Cilësi. Zyra për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Biznesi, Prishtinë, ka rol kyç në organizimin, administrimin dhe analizimin e këtij procesi dhe përbën strukturën kryesore institucionale për sigurimin e cilësisë së brendshme.

Procesi i vlerësimit ndërkolegial është realizuar në mënyrë transparente dhe konfidenciale, duke garantuar anonimitetin e respondentëve dhe duke respektuar standardet etike dhe profesionale të vlerësimit institucional. Rezultatet e këtij raporti paraqiten në formë përmbledhëse dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e veprimeve për përmirësim të vazhdueshëm të bashkëpunimit profesional, zhvillimit të stafit akademik dhe avancimit të proceseve institucionale në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe politikat institucionale të sigurimit të cilësisë.

Vlerësimi ndërkolegial




Pyetësi është i destinuar për stafin akademik. Vlerësimi ndërkolegial realizohet dy herë në vit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik. Pyetësi është lansuar për të gjitha njësitet akademike. Pyetësi është i ndarë në 2 nivele, të cilat vlerësohen nga 1-5.

- **Bashkëpunimi kolegial dhe komunikimi ndërkolegial**
- **Marrëdhëniet ndërpersonale dhe sjellja etike kolegiale**
- **Vlersim nderkolegial**

Pyetësi ka për qëllim identifikimin e përparësive dhe nevojave për përmirësim në marrëdhëniet ndërkolegiale. Mësimdhënësit njoftohen për performancën e tyre çdo semestër përfshirë dhe vlerësimin ndërkolegial. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Në nivel të Kolegjit Biznesi, stafi akademik në kuadër të vlerësimit ndërkolegial është vlerësuar në intervalin mesatar nga 4.3 deri në 4.8 në shkallën 1–5, çka reflekton nivel të lartë bashkëpunimi profesional, respektim të marrëdhënieve ndërpersonale dhe angazhim në aktivitetet institucionale. Rezultatet sipas programeve studimore tregojnë performancë shumë të mirë të stafit akademik në të gjitha programet. Në Programin Studimor **Menaxhment dhe Financa – MA**, stafi akademik është vlerësuar me mesatare **4.6**, ndërsa në Programin Studimor **Menaxhimi i Emergjencave – MA** me mesatare **4.5**. Programi Studimor **Menaxhment dhe Ekonomiks – BA** është vlerësuar me mesatare **4.4**, ndërsa Programi Studimor **Banka dhe Financa në Biznes – BA** me mesatare **4.4**. Gjithashtu, Programi Studimor **Menaxhimi i Emergjencave – BA** është vlerësuar me mesatare **4.5**, Programi Studimor **Juridik – LLB** me mesatare **4.3**, ndërsa Programi Studimor **Shkenca Kompjuterike – BSc** është vlerësuar me mesatare **4.4**.

Këto rezultate tregojnë nivel të kënaqshëm shumë të lartë të bashkëpunimit ndërkolegial, komunikimit profesional dhe respektimit të etikës akademike në kuadër të programeve studimore, duke reflektuar kulturë institucionale bashkëpunimi dhe përkushtim ndaj zhvillimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike.



Përfundim

Bazuar në rezultatet e vlerësimit ndërkolegial për vitin 2024/2025 dhe numrin e përgjithshëm të përgjigjeve të marra nga stafi akademik, mund të konstatohet se performanca ndërkolegiale në Kolegjin Biznesi është në nivel të kënaqshëm deri shumë të mirë, me një mesatare të përgjithshme në intervalin 4.3 – 4.8 në shkallën 1–5. Këto rezultate dëshmojnë për bashkëpunim të mirë profesional, komunikim efektiv ndërmjet stafit akademik dhe respektim të etikës profesionale në marrëdhëniet ndërpersonale.

Rezultatet sipas programeve studimore tregojnë performancë pozitive në të gjitha njësitë akademike, duke reflektuar nivel të lartë angazhimi në proceset institucionale, bashkëpunim profesional dhe kulturë organizative të bazuar në respekt dhe përgjegjësi të ndërsjellë. Megjithatë vërehen dallime të vogla ndërmjet programeve studimore, të gjitha programet kanë treguar rezultate të kënaqshme, duke krijuar bazë të mirë për përmirësim të vazhdueshëm përmes planifikimit institucional dhe zhvillimit profesional të stafit akademik.

Njëkohësisht, analiza e rezultateve tregon nevojën për rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në procesin e vlerësimit ndërkolegial në mënyrë që të sigurohet reflektim më i plotë dhe më përfaqësues i marrëdhënieve profesionale dhe bashkëpunimit ndërkolegial në kuadër të programeve studimore. Rritja e pjesëmarrjes në këtë proces mbetet objektiv i rëndësishëm për forcimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale.